

FJALA E DEPUTETES MILVA EKONOMI

E HËNË 11 PRILL 2022

E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Shumë të nderuar qytetarë,

Në fakt, ne vijmë sot në këtë seancë speciale të parlamentit pas një jave me dy aktivitete shumë të rëndësishme për Partinë Socialiste: së pari, publikimi i rezultateve të Këshillimit Kombëtar dhe, së dyti, Kongresi Kombëtar i Partisë Socialiste. Këshillimi Kombëtar ishte procesi kulminant i një mënyre të re të komunikimit me qytetarët, por, gjithashtu, ishte edhe një koncept i ri i ushtrimit të mandatit të tretë që ne e fituam me votën e të gjithë votuesve. Qeveria jonë socialiste marrëdhënien me qytetarin e ka shumë të rëndësishme, madje për këtë ne hartuam edhe një ligj të veçantë, që e na e bëri marrëdhënien më të drejtpërdrejtë. Kjo nuk do të ishte e mundur nëse gjatë kësaj periudhe nuk do të kishim arritur të realizonim dhënien e shërbimeve administrative, publike online për qytetarët tanë. Sot 95% e shërbimeve publike jepen online dhe këto shërbime u kanë kursyer qytetarëve shqiptarë 766 vjet me radhë, 6,5 milionë euro dhe i ka kushtuar 160 milionë letër A4 më pak qeverisjes administrative.

Përfshirja e drejtpërdrejtë e qytetarëve në politikëbërje i jep mundësinë gjithsecilit të japë mendimin e tij, pavarësisht distancës fizike që mund të ketë institucioni me qytetarin, sepse mënyra e dorëzimit të opinionit është lejuar të bëhet në disa forma: online, me postë apo në tendat e ngritura në 61 bashkitë. Prandaj, më shumë se gjysmë milioni qytetarë shqiptarë iu përgjigjën pyetësorit të Këshillimit Kombëtar dhe në 61 bashkitë e vendit ne morëm përgjigje prej tyre. Në fakt, dua t'i falënderoj shumë 19 mijë e 301 mijë qytetarët durrsakë, të cilët u përgjigjën me postë apo u përgjigjën nëpërmjet tendave në të gjithë Durrësin. Dua t'i siguroj qytetarët shqiptarë që informacionet, të cilat japin, janë informacione që i mbron konfidencialiteti i të dhënave. Qytetarët u bënë bashkë me ne dhe morën pjesë në bashkëqeverisje për tema shumë të rëndësishme, si: shëndetësia, trajtimi i shtresave vulnerabël të shoqërisë sonë, si nënat me fëmijë të mitur; pensionet, punësimi, fiskaliteti, drejtësia, mjedisi, integrimi dhe politika e jashtme dhe "Ballkani i hapur". Duke marrë përgjigje nga këto, pa dyshim që e gjithë administrata jonë duhet të marrë përsipër të punojë me akte të tjera ligjore, të hartojë paketa speciale për t'i ardhur në ndihmë zgjidhjes së këtyre ideve që ndamë së bashku.

Së pari, "Open Balkan" mori një mbështetje shumë të fortë nga Këshillimi Kombëtar, 59% e qytetarëve votuan, sepse ajo është një nismë jo vetëm në interes të fqinjësisë së mirë, por edhe një nismë që, në thelb, u shërben të gjithë shqiptarëve. Duke hequr kufijtë për lëvizjet e mallrat, për shërbimet, për kapitalet dhe për njerëzit, pra duke hequr fragmentarizmin nga rajoni ynë, ai synon një hapje të ekonomike, e cila sjell një rritje më të madhe ekonomike për të gjitha vendet. Opinioni i shqiptarëve ishte pozitiv për sa i përket amnitisë fiskale, e cila merr përsipër në një mënyrë shumë të detajuar të formalizojë kursimet nga djersa e ndershme e shqiptarëve në emigracion, të cilët duan t'i sjellin ato

kursime në vendin tonë. Ato dhanë edhe një opinion në lidhje me ndëshkimin që duhet të kenë punëdhënësit abuzues, kur nuk paguajnë siç duhet punëmarrësit e tyre. Prandaj, masat ndaj tyre duhen shtrënguar.

Gjithashtu, një vëmendje të veçantë mori edhe mbrojtja e nënave me shumë fëmijë të mitur, duke u garantuar atyre një paketë mbështetëse, e cila duhet të jetë shumë dimensionale dhe në këtë formë duhet të punojë qeveria. Nga ana tjetër, në këtë Këshillim Kombëtar ne pyetëm edhe për ata, që janë në moshë të tretë, për pensionistët, që kanë dalë në pension e vazhdojnë të punojnë për familjen dhe ndihmojnë të afërmit e tyre në bizneset e vogla. Të gjithë kërkuan që për ta të mos njihej më sigurimi shoqëror. Ndaj, qeveria jonë duhet të punojë duke e dëgjuar mirë me veshin e saj të gjithë këtë zë që vjen nga bashkëqeverisja. Megjithatë, në Kongres, duke pasur parasysh këto rezultate, patëm në vëmendje tri çështje kryesore: sigurinë, përkujdesjen dhe zhvillimin. Prandaj, edhe planet tona të ardhshme kanë të bëjnë me sigurinë, e cila në këtë moment të luftës që po ndodh në Europë duhet të ketë një vëmendje më të madhe, duhet një rritje e sigurisë kombëtare dhe një përkujdesje ekonomike sociale për të gjithë qytetarët.

Përkujdesje do të thotë më shumë vëmendje për shtresat në nevojë, për një mjedis mbrojtës ndaj tyre, por kjo përkujdesje ndaj shtresave në nevojë duhet të shoqërohet edhe me përkujdesje tjetër, që është përkujdesja ndaj mjedisit, sepse vetëm kështu ne do të lëmë një mjedis më të mirë dhe më të drejtë për brezat tanë të ardhshëm që të jetojnë në vendin tonë nesër. Zhvillimi ekonomik dhe social i qytetarëve është objektivi ynë. Duhet të keni parasysh që ne po mundohemi fort nëpërmjet tregut të hapur, nëpërmjet “Ballkanit të hapur”, të krijojmë më shumë vende pune, duke mbështetur inovacionin dhe prodhimin në sektorët strategjikë, por bashkë me këtë duke u kujdesur shumë edhe për profesionet e reja që duhen për të shkëmbyer më shumë midis nesh. Ne, socialistët, Këshillimin Kombëtar e shikojmë më shumë si një praktikë politike, e cila kërkon bashkimin, jo ndarjen, sepse për ne mënyra se si duhet të punojmë për Shqipërinë e së nesërme është një mënyrë bashkimi. Ne duhet ta shikojmë të gjithë bashkë, sidomos në këto kushte që janë kaq specifike për kohën, dhe duhet ta mendojmë të gjithë së bashku vizionin për Shqipërinë tonë të së ardhmes, pavarësisht nga përkatësit tona politike.

Ne më shumë se kurrë duhet të kujdesemi fort për njëri-tjetrin, sidomos duhet të kujdesemi për shtresat në nevojë. Prandaj, përkujdesja do të jetë kryefjala jonë në politikën e ditëve që vijnë. Për këtë arsye, ne nuk e hartuam kot paktën e rezistencës sociale. Kjo paketë ka të bëjë me mbrojtjen, që po u bëhet të gjitha familjeve shqiptare dhe atyre që janë në nevojë, nga çmimet të befasishme në rritje nga lufta në rajon. Ju e dini shumë mirë që nga data 1 prill kanë filluar të paguhen me ndihmë ekonomike 30 mijë lekë në muaj familje, që kanë persona në nevojë, apo po përfitojnë bonus 673 mijë e 542 pensionistë. Nga ana tjetër, ne nuk e rritëm për asnjë ditë çmimin e energjisë për të gjitha familjet shqiptare dhe për 95 mije biznese të vogla, por u dhamë mundësi bizneseve të mesme, 7400 prej tyre, që të mos e ndienin peshën e rritjes së çmimit të energjisë elektrike. Qeveria jonë krijoi mundësinë për t’u dhënë një shans më të madh atyre që punojnë në transportin urban, duke mos rritur çmimin e biletës për transportin urban dhe ndërqytetës, duke u dhënë kështu mundësi të gjithëve të jenë të barabartë në tregun e punës dhe të mendojnë me shumë kujdes për të ardhurat e tyre në këtë situatë të vështirë të rritjes së çmimeve në të gjithë globin.

Nuk duhet të harrojmë për asnjë çast që edhe Banka e Shqipërisë në mënyrë konstante po e informon shoqërinë tonë në lidhje me inflacionin e së nesërme, të çdo muaji, sepse kjo është një situatë, e cila monitorohet jo vetëm në Shqipëri hap pas hapi, por në të gjitha vendet e Europës. Ndaj, dua të bëj edhe një thirrje: Këshillimi Kombëtar, ku morën pjesë 500 mijë qytetarë, do të jetë një aktivitet përsëritës. Të gjithë do të kenë mundësi të tregojnë problemet që i shqetësojnë më shumë dhe për të thënë nëpërmjet pyetjeve, që u ruhet konfidencialiteti, se cilat janë shqetësimet që duan të adresojnë në Shqipërinë tonë, në Shqipërinë e fëmijëve tanë. Faleminderit!